

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista në Syri Tv -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919501/rama-ne-izolim-zhulali-akshi-dhe-shish-e-ekspozuan-si-kreun-e-nje-shteti-te-lidhur-me-krimin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:01:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:21:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	528e093170a81b1426d26827de9dd045c7cb41d045e6d37f3d5e76b13d007c56
TEKSTI	d844a68b7836fc0642c0892850f14808bc50b57fc39ec9bc271f878990db57aa
PAMJA	6cc17ad35af1b78a086e0ec3d4c4347b5cd8144ab08b41dbeffceb39309af735

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6c473b6fd6e1afb0a8430b398ad2c6cef43f3e86bb53f3cbfdc02270ec92e765
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd7b89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6c473b6fd6e1afb0a8430b398ad2c6cef43f3e86bb53f3cbfdc02270ec92e765>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



NDRIM KULLA

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?




Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin



Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së



'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht



'Rama në izolim', Zhulali: AKSHI dhe SHISH e ekspozuan si kreun e një shteti të lidhur me krimin

15:21, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Drejtesja e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë në PD, Ilda Zhulali, e ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, deklaroi se kryeministri Edi Rama ndodhet, sipas saj, në ditët e tij më të vështira politike dhe ndërkombëtare.

Duke komentuar zhvillimet e fundit, Zhulali tha se Rama është sot "në ditën e izolimit të vet më të madh", ndërsa akuzoi kryeministrin se situata e AKSHI-t dhe SHISH-it e ka ekspozuar atë si kreun e një pushteti që bashkëpunon me krimin e organizuar.

"E kanë ekspozuar atë si kreu i një korporate që e ka bërë shtetin korporatë të krimit të organizuar", u shpreh Zhulali.

Zhulali kritikoi edhe fjalimin e fundit të Ramës, duke e cilësuar si përsëritje të justifikimeve të përdorura nga kryeministri në raste të ndryshme gjatë viteve.

Ajo tha se Rama nuk dha asnjë përgjigje të re përballë situatës ku ndodhet qeveria dhe tashmë duhet të përballet me përgjegjësinë politike.

Zhulali theksoi se mungesa e një dorëheqjeje mund ta çojë situatën drejt një përballjeje tjetër me drejtësinë, duke lënë të kuptohet se kryeministri mund të përballet me zhvillime të reja që lidhen drejtpërdrejt me të.

"Duket sikur i parapriu një bombe tjetër që pritet të vijë drejt tij, me emrin e tij personalisht", deklaroi ajo.

Pjesë nga intervista:



Edi Rama nuk zhgënjën asnjëri, kush priste që të zhgënjehet prej tij dhe të gjente një njeri të përgjegjshëm që krejt papritur erdhi si një njeri që ka mbajtur barrën e gjithë situatës që ndodhet Shqipëria.

Në fakt, ka të njëjtin njeri që iku nga Shqipëria dhe sot është krejtësisht i izoluar ndërkombëtarisht. Ai vjen nga OKB, ku nuk takoi dot asnjëri, nuk bëri dot asnjë takim dypalësh të rëndësishëm, ndryshe nga herët e tjera që ai shfaqet duke u përfaqësuar me liderë të ndryshëm botërorë. Sot ai është në ditën e izolimit të vet më të madh.

Është parë ashtu në ditët e diskreditimit të tij më të madh ndërkombëtar. Kjo që ka ndodhur me situatën e AKSHI-t dhe të Shishit bashkë, sepse këto janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, e kanë ekspozuar atë si kreu i një korporate që e ka bërë shtetin korporatë të krimit të organizuar dhe drejtohet në bashkëpunim me krimin e organizuar. Edhe kësaj përgjegjësie ai nuk i shpëton dot.

Pati një fjalim të gjatë me fjalë që i ka përsëritur në momente të ndryshme. Herë-herë më ngjante si fjalimi që mbahet sipas Saimir Tahirit, herë si fjalimi që mbahet i asaj pas armëve kimike që donte të sillte në Shqipëri, herë si justifikimi që gjente pas ndalimit të Mirlinda Karçanajt, herë si justifikimi që gjente pas kërkesës për dorëzimin e imunitetit të Belinda Ballukut. Pra, është një vazhdimësi e të njëjtit vajtim që e kanë bërë gjatë gjithë këtyre viteve, por sot nuk pati asnjë qëndrim të ri. Të gjithë njerëzit presin vetëm një gjë nga Edi Rama: që ai të largohet.

Dhe në mungesë të largimit të tij me dorëheqje, siç do të ishte normalisht, veprimi i çdo kryeministri apo njeriu të përgjegjshëm që e kupton çfarë do të thotë qeverisja e një vendi, ai pastaj do të ketë një fund tjetër, por në një farë mënyre iu duk sikur i parapriu edhe një daljeje të tij përpara organeve të drejtësisë.

Duket sikur i parapriu një bombe tjetër që pritet të vijë drejt tij, me emrin e tij personalisht. Kështu u duk të paktën, kështu e lexova unë nga mënyra si e trajtoi, por ai, pavarësisht bashkëpunëtorëve që kishte sjellë në një formë apo tjetër, ky ishte krejt i "papërlyeri".

Megjithatë, sot nuk ka njeri dyshim, jo vetëm në Shqipëri, por mendoj edhe nga partnerë që deri dje e kishin mbështetur. Nuk ka njeri që t'i blejë alibitë e tij, t'ia ndërrojë apo t'ia relativizojë.

Kështu që ai sot rikthehet si i njëjti kryeministër, i izoluar dhe i diskredituar botërisht, dhe që pret atë shtyrjen e fundit për ta lëvizur nga pushteti, aq më tepër që e panë vogëlsinë e tij, vrimën ku është futur, i vogël.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Blushi: Rama firmosi në shkelje të ligjit për inceneratorët, ja dy rastet që e implikojnë



Skandali i rëndë i SHISH, Edi Rama nuk mban asnjë përgjegjësi dhe fajëson SPAK e mediat opozitare!



Krejt qeverinë dhe bashkëpunëtorët i ka nën hetim ose ne burg, Rama: S'jam engjëll, punoj për të bërë histori

Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet

Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

TË NGJASHME



'Në 8:30 do takoj KM'/ Publikimi i mesazheve të Hysenit me Agasin, Rama sulmon drejtësinë: Nxorën në pazar...



Rama nuk mban asnjë përgjegjësi për skandalin e SHISH, qytetarët i kërkojnë dorëheqje urgjente



Berisha: Anulimi i konferencës për shtyp nga Padrino, kapitullim pa kushte para mediave



Hasi në mbështetje të UÇK-së, qytetarët: Liri për çlirimtarët!



Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet!



Fjalimi në OKB/ Këlliçi: Rama akuzoi shqiptarët për antisemitizëm - do mbahet mend se ktheu Shqipërinë në narkoshtet



Stadiumi jehoi me thirrje kundër Ramës, Bardhi: Në Shqipëri, diasporë, sheshe e shkolla ka vetëm një thirrje, shporru!



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.